



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 13 Prot.

Tiranë, më datë 15.01.2021

VENDIM

Nr. 3, datë 15.01.2021

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 15.01.2021,

VENDOSI:

1. Miratimin e fazës së projekt zbatimit “Linja Ajrore me Dy Qarqe Tirana 2 - Rrashbull dhe Unaza e Tiranës 110 kV.”, me aplikues OST sh.a.
 - Të realizohet sondazh arkeologjik në shtyllën numër 10, pranë zonës së Rrashbullit.
 - Investitori duhet të kontraktojë një subjekt të licencuar në arkeologji, i cili të përgatisë konceptin e sondazhit arkeologjik për shqyrtim dhe vendimmarrje në KKTKM e rradhës (për shtyllën Nr. 10 të Linjës)
2. Për pjesën tjetër, Investitori duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje 3 palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, i cili do të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve të gërmimit për projektin “Linja Ajrore me Dy Qarqe Tirana 2 - Rrashbull dhe Unaza e Tiranës 110 kV.”, si dhe Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, i cili do të mbikëqyrë këtë subjekt.
3. Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij Vendimi;
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
5. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Arta DOLLANI

KRYETAR
Elva MARGARITI

